



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:027948

Datë: 20.06.2018

Numri i dokumentit: 00074101

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

QENDRIMI ËSHTË I PLOTËFQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROSEVAC

P.nr.818/2018

Më  
Data

23.08.2018

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari Adem Shabani, me praktikanten Marigona Shaqiri, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve [REDACTED] nga Prishtina, lagja e Spitalit, rruga "[REDACTED]", [REDACTED] nga Fushë Kosova, rruga "[REDACTED]" dhe [REDACTED] nga Prishtina, rruga "[REDACTED]", [REDACTED] nr. [REDACTED] me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1046-7/2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar me pjesëmarrjen e të akuzuarit [REDACTED] dhe mbrojtësi i tij me autorizim Av. [REDACTED] nga Prishtina, të akuzuarit [REDACTED] dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare Av. [REDACTED] nga Ferizaji dhe i akuzuari [REDACTED] me mbrojtësen e tij me autorizim Av. [REDACTED] të dt.18.06.2018, të njëjtën ditë pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 20.06.2018 mori këtë:

**AKTGJYKIM**

**Të akuzuarit:**

1. [REDACTED], nga Prishtina, Lagja e Spitalit rruga "[REDACTED]", [REDACTED] nga Fushë Kosova, rruga "[REDACTED]", i lindur me [REDACTED] nga babai [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] të vajzërisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion tregtar, ka të kryer shkollën e mesme me numër personal [REDACTED] gjende në paraburgim nga data 22.05.2018.

2. [REDAKTUAR] nga Fushë Kosova, rruga [REDAKTUAR], i lindur me [REDAKTUAR] nga babai [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR], të vajzërisë [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion tregtar, ka të kryer shkollën fillore mi gjendjes së dobët ekonomike me numër personal [REDAKTUAR] gjende në paraburgim nga data 22.05.2018.

3. [REDAKTUAR], nga Prishtina, rruga [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR] i lindur me [REDAKTUAR] nga babai [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] të vajzërisë [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion tregtar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDAKTUAR] gjendet në paraburgim nga data 22.05.2018.

## JANË FAJTOR

### SEPSE:

- me datë 30 prill 2018 rreth orës 15:30h, në rrugën "12 Qershori" në Ferizaj, të pandehurit, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete dhe shkaktimit të dëmit material personit tjetër, e mashtrojnë të dëmtuarin [REDAKTUAR], ashtu që fillimisht të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] shkojnë tek firma "[REDAKTUAR]" dhe marrin në shfrytëzim për tri ditë veturën e markës "[REDAKTUAR]" me ngjyrë të bardhë, me tabela regjistrimi [REDAKTUAR], me ç' rast përpilojnë edhe një kontratë të cilën e nënshkruan i pandehuri [REDAKTUAR] si dhe paguajnë avancë shumë e të hollave prej [REDAKTUAR] dhe me të njëjtën veturë me datë 2 maj 2018, tre të pandehurit, shkojnë në Republikën e Shqipërisë, me ç' rast i pandehuri [REDAKTUAR] luan bixhoz në një kazino në Tiranë dhe pas humbjes së të hollave në shumë prej 5000 euro, veturën në fjalë ia lë peng pronarit të kazino me nofkën [REDAKTUAR], ndërsa pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore të Policisë së Kosovës dhe asaj të Republikës së Shqipërisë, me datë 06.06.2018, të dëmtuarit ti kthehet vetura nga prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në Tiranë,-

-me të cilën në bashkëkryerja kanë kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke u bazuar në bazë të nenet 4, 7, 17, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73, 74, 75, 76, 80 dhe 83, si dhe nenit 335 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, dhe neneve 365, 370, 450, 453 dhe 463 të KPPRK-së, i:

## GJYKON

### DËNIM ME BURGIM DHE DËNIM ME GJOBË

I. Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje, prej 6 / gjashtë / muajve, në të cilën dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.05.2018 deri me dt. 20.06.2018, dhe dënim me gjobë në shumë nga 1000 / njëmijë /

€uro, të cilat dënimet do të ekzekutohen në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita ku ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje, prej 6 / gjashtë / muajve, në të cilën dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.05.2018 deri me dt. 20.06.2018, dhe dënim me gjobë në shumë nga 1000 /njëmijë / €uro, të cilat dënimet do të ekzekutohen në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita ku ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje, prej 6 / gjashtë / muajve, në të cilën dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.05.2018 deri me dt. 20.06.2018, dhe dënim me gjobë në shumë nga 1000 /njëmijë / €uro, të cilat dënimet do të ekzekutohen në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita ku ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

II. Pas shpalljes së aktgjykimit gjykata konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] dhe mbrojtësve të tyre dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë / muajve, duke iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.05.2018 deri me dt. 20.06.2018, e mbetur edhe nga 5 / pesë / muaj, ju zëvendësohet me dënim me gjobë secilit të akuzuar veç e veç nga 3.000 / tremijë /,€uro.

### III. Konform nenit 80 paragrafi 1 të KPRK-së

1. Të akuzuarit [REDAKTUAR] dënimin unik me gjobë në shumë prej 4000 /katërmijë/ €uro, është i obliguar te paguajë, në afatin ligjor prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi në të kundërtën gjoba do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur për çdo 20 €uro 1 dite burgim.

2. Të akuzuarit [REDAKTUAR] dënimin unik me gjobë në shumë prej 4000 /katërmijë/ €uro, është i obliguar te paguajë, në afatin ligjor prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi në të kundërtën gjoba do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur për çdo 20 €uro 1 dite burgim.

3. Të akuzuarit [REDAKTUAR] dënimin unik me gjobë në shumë prej 4000 /katërmijë/ €uro, është i obliguar te paguajë, në afatin ligjor prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi në të kundërtën gjoba do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur për çdo 20 €uro 1 dite burgim.

IV. I dëmtuar [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga " [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasuror juridike është udhëzuar në kontest civil.

V. Obligohen të akuzuarit në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 180/njëqind e tetëdhjetë / €uro në emër të paushallit gjyqësor dhe taksës për Kompensimin e viktimave të

krimin secili veç e veç shumën nga 60 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

VI. Gjykata konform nenit 367 par.1 nën par 1.2 të KPPRK-së, kundër të akuzuarve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] pas shpalljes së aktgjykimit i ka ndërprerë paraburgimin dhe të akuzuarit i ka lëshuar në liri menjëherë me datën 20.06.2018.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj -Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP.II.nr.1046-7/2018 të dt.18.06.2018 i ka ngarkuar të akuzuarit: [REDAKTUAR] nga Prishtina, lagja e Spitalit, rruga "[REDAKTUAR]", [REDAKTUAR] nga Fushë Kosova, rruga "[REDAKTUAR]" dhe [REDAKTUAR] nga Prishtina, rruga "[REDAKTUAR]", [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR] -me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-së,

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.20.06.2018, ka caktuar seancën fillestare, ku kanë prezantuar: prokurorja e shtetit Sebahate Sinani të akuzuarit, [REDAKTUAR] dhe mbrojtësi i tij me autorizim [REDAKTUAR] i akuzuari [REDAKTUAR] dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av. [REDAKTUAR] i akuzuari [REDAKTUAR] dhe mbrojtësja e tij me autorizim av. [REDAKTUAR]

Në fillim të shqyrtimit fillestar të akuzuarit janë udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarve janë respektuar, e më pas prokurorja e shtetit, i ka lexuar aktakuzën të akuzuarve dhe pasi që gjyqtari është bindur se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën, të njëjtëve i ka dhënë mundësi të deklarohen mbi fajësinë apo pafajësinë lidhur me veprën penale për të cilën akuzohen.

I akuzuari [REDAKTUAR] ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar si në dispozitiv të aktakuzës pendohet për veprën penale që e ka kryer, ka premtuar se nuk do të përsëris veprime të tilla në të ardhmen i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të merre për bazë pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës penale.

Për të akuzuarin [REDAKTUAR] mbrojtësi i tij me autorizim av. [REDAKTUAR], nga Prishtina ka deklarua se pranimin e fajësisë e ka bërë i akuzuari [REDAKTUAR] pas konsultimit të nevojshëm me te dhe është njoftuar me pasojat dhe favore të pranimit të fajësisë mbështetur në provat që gjinden në shkresat e lëndës, i propozon gjykatës që ta pranon pranimin e fajësisë që gjatë matjes së dënimit të merre parasysh, pendimin e tij sinqeritetin, i martuar mbajtës i familjes dhe propozon që gjykata që gjykata ti shqiptoj një dënim me zbutje mundësisht nën minimumin e paraparë me ligj.

I akuzuari [REDAKTUAR] ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar si në dispozitiv të aktakuzës pendohet për veprën

penale të kryer me të akuzuarit të tjerë, ka premtuar se nuk do të përsërisë veprime të tilla i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të merre për bazë pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës penale.

Për të akuzuarin [REDAKTUAR], mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtar av. [REDAKTUAR] ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri [REDAKTUAR] e ka kuptuar natyrën dhe pasojën e pranimin të fajësisë, për veprën penale që e ngarkon aktakuza pranimin e ka mbështetur në provat tjera që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale, ku është konsultuar me të lidhur me pranimin e fajësisë, dhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merre për bazë si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës, pendimin për veprën penale që e ka kryer, premtimin se më nuk do të përsërisin vepra të tilla, i martuar baba i një fëmije i kërkon falje të dëmtuarit andaj i propozon gjykatës që të zbatoj dispozitat e nenit 75 të KPRK-së të zbus dënimin kundër të mbrojturit të tij në minimumin e paraparë me ligj, dhe ka propozuar gjykatës që kundër të pandehurit ti ndërpritet paraburgimi pasi kanë pushuar të gjitha arsyet që ti vazhdohet paraburgimi, dhe ka kërkuar që menjëherë të lirohet në liri.

I akuzuari [REDAKTUAR] ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, pendohet për veprën e kryer ka premtuar se më nuk do të kryej vepra të tilla.

Për të akuzuarin [REDAKTUAR], mbrojtësit të tij me autorizim av. [REDAKTUAR] ka deklaruar se mbështet pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i im, prani të cilin e ka bërë edhe gjatë fazës hetimore duke shprehur pendimin e thellë për veprën penale që e ka kryer pranimin e ka bërë vullnetarisht dhe konsultimet para shqyrtimit fillestar me të, lidhur me të mirat e pranimin të fajësisë në këtë fazë të procedurës, i ka propozuar gjykatës që ta pranon pranimin e fajësisë lidhur me veprën penale që akuzohet, me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata të merre për bazë rrethanat veçanërisht lehtësuese, pendimin e thellë të tij, premtimin se më nuk do të kryej vepra penale, është familjarë baba i pesë fëmijëve, në vendin ku jeton ka respekt kurrë s'ka pasur me ta diçka të keqe, nuk ka të kaluar kriminale, i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të aplikoj dispozitat e neneve 75 dhe 76 të KPRK-së, dhe se me rastin e ngritjes së aktakuzës nga prokurori i shtetit nuk është dhënë propozim për vazhdimin e paraburgimit dhe se në shqyrtimin fillestar i mbrojturi i saj ka pranuar fajësinë pra kanë pushuar të gjitha shkaqet ligjore që ti vazhdohet paraburgimi por ti ndërpritet menjëherë dhe të lirohet në liri.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarve gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në shqyrtimin fillestar.

Prokurorja e shtetit Sebahate Sinani, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve për veprën penale që akuzohen se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe me nenin 31 të të KPRK-së, dhe se pranimin e kanë mbështetur në dispozitat e nenit 248 të KPRK-së, bazuar në provat që gjinden në shkresat e lëndës e në veçanti me vërtetimin mbi sekuestrim dhe kthim të sendit dhe kërkon nga gjykata që pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ta pranoj dhe nuk propozon që të akuzuarve ti vazhdohet paraburgimi pasi të njëjtit në shqyrtimin fillestar e kanë pranuar fajësinë për veprën penale që akuzohen.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjyqtari ka konstatuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza në Raportin e oficerit i datës 24.05.2018, polisa e sigurimit e veturës Range Rover, kopja e të dhënave nga GPS, kontrata për dhënien me qira të veturës e datës 30.04.2018, fotografit e veturës dhe dokumentacionit, deklarata e të pandehurve, raporti mbi deklarimin e rastit në polici i datës 07.06.2017, urdhër për kthimin e sendeve të sekuestruara i datës 01.06.2018, nga prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në Tiranë, procesverbali për kthimin e sendeve të sekuestruara i datës 06.06.2018, lëshuar nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, si dhe shkresave tjera që gjinden në këtë lëndë penale dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike se të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] - me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Pas deklarimit të të akuzuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] se e pranojnë fajësinë për veprën penale, mashtrimi nga neni 335 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe me nenin 31 të të KPRK-së, të cilin pranim të fajësisë e kanë bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre, duke qenë të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, më të cilin pranim fajësie është pajtuar edhe prokurori i shtetit, gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, pikërisht se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, të pranuar nga të akuzuarit, prandaj, gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve ngase janë përmbushur kushtet për pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës penale.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve, mbrojtësit e të akuzuarit [REDAKTUAR] me autorizim av. [REDAKTUAR], mbrojtësit të akuzuarit [REDAKTUAR] sipas detyrës zyrtare av. [REDAKTUAR], për të akuzuarin [REDAKTUAR] mbrojtësja me autorizim av. [REDAKTUAR], dhe prokurori i shtetit Sebahate Sinani në tërësi janë pajtuar me pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe kanë kërkuar nga gjykata që pranimin e fajësisë ta aprovojë si të bazuar në shqyrtimin fillestar.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, sjelljen e tyre korrekte në shqyrtimin fillestar, pendimin e tyre të shprehur për veprën penale të kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do ta përsërisin veprimet e tyre, janë të martuar dhe mbajtës të familjes, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, gjykata i ka vlerësuar këto rrethana duke i ndërlidhur njëra me tjetrën janë rrethana që tregojnë se edhe me një dënim më të butë, andaj mbi bazën e rrethanave të tilla gjykata konform nenit 75 dhe 76 të KPRK-se për të katër të akuzuarit bëri zbutjen e dënimit dhe u vërtetoi të katër të akuzuarve dënimet si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarve konform nenit 41 të KPRK-së.

Të akuzuarve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në dënimin e shqiptuar me burgim iu është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 22.05.2018 deri me dt.20.06.2018, dhe në kuptim të nenit 367 par.1.nënpar 1.2 të KPPK-së me aktvendim të veçantë iu është ndërprerë masa e paraburgimit, derisa aktgjykimi të merre formën e prerë, për shkak se tani kanë pushuar arsyet për të cilat ka qenë i caktuar paraburgimi.

Konform nenit 463 par.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, i dëmtuari: [REDAKTUAR] nga Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Konform nenit 450 par.2 nën par.2.6 neni 451 të KPPRK-së, Obligohen të akuzuarit në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 90/nëntëdhjetë/ Euro në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën nga 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal,  
P.nr.818/2018 me datë 20.06.2018

Numri i lëndës: 2018:027948  
Datë: 20.06.2018  
Numri i dokumentit: 00074101

Praktikante  
Marigona Shaqiri

Gjyqtari

Adem Shabani



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar, ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate